Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

VAZHDIM I LEJES MJEDISORE TË INTEGRUAR

"NewCO Ferronikeli Complex" L.L.C. Fabrikë për prodhimin e Ferronikelit

Gllogoc
Republika e Kosovës

LEJE Nr. 30

Përmbajtja

PARATHËNIE 3
LEJA MJEDISORE TË INTEGRUAR 7
Vendim për dhënien e Lejes Mjedisore të Integruar 7
1. KUSHTET E PUNËS SË IMPIANTIT 7
2. ÇËSHTJET OPERACIONALE 10
2.1. Kontrolli dhe Teknikat e Menaxhimit 10
2.2 Lëndët e para dhe lëndët ndihmëse (Aditivët) 10
2.3. Shfrytëzimi dhe efiçienca e energjisë 11
2.4 Gatishmëria Emergjente ..... **Error! Bookmark not defined.**12
2.5 Dekomisionimi dhe rehabilitimi 14
3. ÇËSHTJET MJEDISORE 14
3.1 . ATMOSFERA 14
3.1.1 Shkarkimet në ajër (emisionet) 14
3.2 UJËRAT 19
3.2.1. Konsumi i ujërave 19
3.2.2. Shkarkimet në ujëra 20
3.2.3. Mbrojta e ujërave nëntokësor 22
3.3 MBETURINAT 23
3.3.1. Prodhimi, magazinimi dhe menaxhimi 23
3.4 ZHURMA 27
4. PROGRAMI I PËRMIRËSIMIT 29
5. DISPOZITAT TJERA 30
5.1. EVIDENCA 30
5.2. RAPORTIMI DHE NJOFTIMET 30
5.3 VLEFSHMËRIA DHE DISPOZITAT PËR NDRYSHIM 32
PËRFUNDIMI 33
ARSYESHMËRIA 33
PLANI PËR VETËMONITORIM 34

LEJA MJEDISORE E INTEGRUAR

PARATHËNIE

Leja Mjedisore e Integruar është lëshuar sipas Ligjit Nr. 08/L-145 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes, për vënien në funksion të një impianti, në këtë rast Fabrika "NewCo Ferronikeli Complex" L.L.C. ku kryhen aktivitetet e renditura në Shtojcën 1 të këtij Ligji, deri në atë masë sa e autorizon Leja.

Leja i përfshinë kushtet të cilat duhet të respektohen.

Një përshkrim i shkurtër i impiantit, operimi i të cilit rregullohet përmes kësaj Leje

"NewCo Ferronikeli Complex" L.L.C. është impiant ekzistues dhe si i tillë objekti (fabrika) është ndërtuar dhe lëshuar në punë në bazë të të gjithë dokumentacionit të nevojshëm pronësor, urbanistik, të organeve kompetente të ish KSAK, nga viti 1978 - 1984. I njëjti objekt (fabrika), është privatizuar në vitin 2006, sipas rregullave për privatizim të kompanive nga shteti përmes AKM-së.

Fabrika "NewCo Ferronikeli Complex" L.L.C. e cila merret me prodhimin e Fero-Nikelit gjendet në Gllogoc, Rruga "Besim Mala" nr.227, numër të regjistrimit të biznesit 70268073, Numri i Çertifikatës UL-70315052-00167 në zonën kadastrale Çikatovë e Re e vërtetuar nga Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë e Komunës së Gllogocit, e cila është kompani private.

Procesi teknologjik i prodhimit të Ferrinikelit

Procesi teknologjik i "FERRONIKELIT" e rifillon rrjedhën duke eksploatuar minierat sipërfaqësore. Gjatë punës së fabrikës, nevojat për xehe mbulohen nga:

- Xehet lokale nga 2 minierat tona të hapura (Çikatova- 1 km larg fabrikës në lindje dhe Gllavica - 13 km larg fabrikës në jug).
- Xehet nga jashtë (Shqipëria, Indonezia, Filipinet, Turqia, Guatemala (minierë e Corex Holding BV që e zotëron edhe Ferronikelin) si dhe në të ardhmen xehe nga Afrika.

Pas mihjes në minierë, dhe sjelljes së xehes në fabrikë (lokale apo asaj nga jashtë) procesi teknologjik i FERRONIKELIT është:

- Pas **bluarjes** në madhësi 0-50 mm, xehja dërgohet në shtregën për xehe. Nga shtrega xehja dërgohet në bunkerët furnizues dhe bashkë me linjit në shiritat transportues (dy shirita për xehe, një shirit për linjit). Xehja dhe linjiti pastaj furnizohen në furrën rrotulluese;
- **Tharja** dhe **pjekja** e xehes bëhet në furrat rrotulluese (dy furra rrotulluese, 100m të gjata, me diametër 5m). Ngrohja e furrave rrotulluese bëhet me përdorimin e mazutit si lëndë djegëse si dhe petkoksit;
- Xehja e pjekur lëshohet apo hudhet në një kazan dhe përmes vinçave në lartësi bartet në furrën elektrike;
- Gazrat dhe pluhuri që dalin nga furrat rrotulluese trajtohen në precipitatorët elektrostatik.

- **Shkrirja** bëhet në furrën elektrike (teknologjia ELKEM), në temperaturë prej 1400-1600°C. Shkrirja krijon skorien nga furra elektrike e cila para se të dërgohet në deponinë e skories kthehet në formë granulash. Deponia e skories ndodhet rreth 500 m në lindje të fabrikës nga rrethoja e saj. Ekzistojnë dy furra shkrirëse elektrike. Trajtimi i gazrave dhe pluhurit bëhet në skruberë me ujë.;
- **Rafinimi** i ferronikelit si lëndë e parë (13-16% Ni) bëhet në konvertor vertikal (dy konvertorë), duke fryrë oksigjen dhe shtimin e gurit gëlqeror apo gëlqeres. Rafinimi krijon skorien e konvertorit e cila dërgohet në impiantin magnetik për ndarje (tash një thërrmues mobil) e që ndodhet në largësi prej 250 m. Gazrat që lirohen (dalin) trajtohen në skruber me ujë (pajisje pastruese me ujë);
- **Ndarja** e ferronikelit të rafinuar në formë granualsh për arsye komerciale të tregut (po ashtu është edhe mundësia e dytë nëse kërkohet në treg në 25 kg ingotë-kallëp)

Lëndët e para dhe ato ndihmëse, energjia dhe uji

Gjatë vitit 2023 në fabrikën "NewCo Ferronikeli" L.L.C. është punuar vetëm 5 muaj (Qershor-Tetor). Në këtë periudhë kohore janë prodhuar gjithsej 2728 ton nikel. Prodhimi i nikelit ndryshon nga viti në vit, me ç'rast edhe konsumi i lëndëve të para dhe atyre ndihmëse ndryshon në varësi të procesit teknologjik dhe zgjedhjes së llojeve të xeheve dhe lëndëve të tjera. Në tabelën vijuese është paraqitur një përmbledhje e konsumit të lëndëve të para gjatë vitit 2023 (për kohën sa është punuar).

Emërtimi	Njësia matëse	Konsumi
Xehe	Ton/vit	336282
Linjit	Ton/vit	14602
Qymyrguri	Ton/vit	15584
Koks	Ton/vit	21
Masë elektroda	Ton/vit	259
Guri gëlqeror	Ton/vit	14074
Gëlqerja	Ton/vit	48
Biomasa	Ton/vit	0
Oksigjeni (i lëngët)	Ton/vit	423
Oksigjeni (gaz)	Ton/vit	3205
Material zjarrdurues	Ton/vit	1216
Mazut për proces të prodhimit	Ton/vit	1839
Mazut për ngrohje	Ton/vit	326
Pet-koksi	Ton/vit	8577
Gazi propan-butan	Ton/vit	44
Energjia e importuar (përmes KEDS/KESCO)	MWh/vit	161795
Konsumi i ujit (për pije, kuzhinë, sanitari, etj.)	m^3/vit	4217
Konsumi i ujit për nevoja industriale	m^3/vit	1552307
Prodhimi i nikelit	Ton/vit	2728

Energjia elektrike: Linja e tensionit të lartë 220 kV furnizon nënstacionin kryesor elektrik përmes dy linjave 220 kV në zonën e fabrikës nga termocentrali Kosova B, rreth 20 km nga fabrika. Nevojat vjetore të fabrikës për energji elektrike janë rreth 60 MWh për 1 ton të nikelit.

Lejet e tjera valide që i takojnë këtij impianti:

Mbajtësi i Lejes	Numri i Lejes	Data e lëshimit
Leja Mjedisore e Integruar për "NewCo Ferronikeli Complex" L.L.C. për fabrikën e ferronikelit	Nr.12/593/102/ZSP-237/14	30.10.2014
Pëlqimi Mjedisor, për shkritoren e "NewCo Ferronikeli Complex" LLC, Gllogoc, lëshuar nga MMPHI	Nr. 07/1403/1-ZSP-1488	13.07.2007
Pëlqimi Mjedisor, për tharëset për xehe në "NewCo Ferronikeli Complex" LLC, Gllogoc, lëshuar nga MMPHI	Nr.21/2842/1-ZSP/05/22	08.06.2022
Pëlqimi Mjedisor për stacionin për prodhimin e Oksigjenit, lëshuar nga MMPHI	Nr. 09/2084/1-ZSP/10	11.01.2010
Leje Ujore për shfrytëzim, lëshuar nga MMPHI	Nr.5564/23-ZSP-2024	28.01.2025
Leje Ujore për shkarkim, lëshuar nga MMPHI	Nr.5565-3/24-ZSP-2024	27.01.2025

Konfidencialiteti

Leja Mjedisore e Integruar kërkon që Operatori të dorëzojë informacionin përkatës tek Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, e cila e fut këtë informacion në regjistrat publik në pajtim me kërkesat e Ligjit Nr. 08/L-145 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes.

Nëse Operatori e konsideron ndonjërin prej informacioneve si konfidencial, në aspektin komercial apo industrial, atëherë mund të aplikojë te që kjo e fundit ta mbajë këtë informacioni të fshehtë, duke mos e futur atë në regjistrat publik, në pajtim me Ligjin Nr. 08/L-145 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes.
Në mënyrë që Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, të jetë në

gjendje të vendosë nëse informacioni është konfidencial në aspektin komercial, Operatori duhet ta identifikojë qartë informacionin në fjalë dhe duhet t'i specifikojë qartë dhe saktë arsyet pse ai informacion konsiderohet konfidencial. Operatori mund të specifikojë se cilat dokumente apo pjesë të dokumentacionit i konsideron si konfidenciale, në aspektin komercial dhe industrial. Operatori duhet t'i theksojë argumentet pse informacionet përkatëse duhet të shpallen konfidenciale nga Ministria.
Informacioni në fjalë dhe argumentimi për konfidencialitetin e tyre duhet të dorëzohen bashkë me lejen mjedisore të integruar në një zarf të posaçëm.

Ndryshimi i Lejes Mjedisore të Integruar

Leja Mjedisore e Integruar mund të ndryshohet në pajtim me Ligjin Nr. 08/L-145 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes.

Dorëzimi i Lejes Mjedisore të Integruar

Operatori duhet ta njoftoj Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, për synimin e tij për përfundimin e pjesërishëm apo të plotë të aktiviteteve të impiantit.
Që aplikuesi të jetë i suksesshëm në synimin e tij, ai duhet të jetë në gjendje t'i dëshmojë Ministrisë se nuk ka rrezik për ndotje.

Transferimi i Lejes Mjedisore të Integruar

Përpara se Leja Mjedisore e Integruar të transferohet tek një person tjetër, duhet të bëhet një aplikim nga të dyja palët, për transferimin e Lejes Mjedisore të Integruar në pajtim me Nenin 21 të Ligjit Nr. 08/L-145 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes.
Nëse Leja Mjedisore e Integruar autorizon kryerjen e një aktiviteti specifik të administrimit të mbeturinave, atëherë duhet të dorëzohet Leja Mjedisore e Integruar, certifikata për administrimin e mbeturinave për personin që është përgjegjës për aktivitetin e tillë.

Regjistri i Gjendjes

Detajet	Data	Komentet
Aplikacionit për Leje Mjedisore të Integruar dhe sipas kërkesës së operatorit "NewCo Ferronikeli Complex" L.L.C Nr.Prot. Nr.Prot.24/4920/MMPHI/498 /DMMU	29.07.2024	
Dokumentacioni shtesë i dërguar nga operatori	11.02.2025	

VAZHDIM I LEJES MJEDISORE TË INTEGRUAR

Leje Nr. 30

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, duke u bazuar në Nenin 30 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.08 /L -145, Ligji Për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes Nr. 08/L-145, si dhe Vendimit të Ministrit të MMPHI-së Nr.3236/22, të datës 03.06.2022, me të cilin Caktohet Forma e Përmbajtjes dhe Mënyra e Plotësimit të Aplikacionit për Leje të Integruar dhe sipas kërkesës së operatorit "NewCo Ferronikeli Complex" L.L.C. me Nr.Prot.24/4920/MMPHI/498/DMMU të datës 29.07.2024, e cila gjendet në Gllogoc, Rruga "Besim Mala" nr.227, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës merr:

VENDIM

Për Vazhdimin e Lejes Mjedisore të Integruar

Operatorit: NewCo Ferronikeli Complex L.L.C

Adresa : Rruga "Besim Mala" nr.227

Kodi Postar Qyteti : 13000 Gllogoc

Shteti : Republika e Kosovës

Numri i Regjistrimit të Kompanisë: 70268073

Zona Kadastrale: Çikatovë e Re

Numri i zones kadastrale:70315052

Numri i Çertifikatës: UL-70315052-00167

Për operimin e Impiantit në:Gllogoc

Emri i plotë i impiantit: "NewCo Ferronikeli Complex" L.L.C

Sekretari i Përgjithshëm i MMPHI-së:

Izedin Bytyqi, U.D. Sekretar i Përgjithshëm i MMPHI-së

Nënshkrimi:_____

Datë:_____

1. KUSHTET E PUNËS SË IMPIANTIT

1.1. Operatori është i autorizuar të kryejë aktivitetet dhe/ose aktivitetet shoqëruese të specifikuara në Tabelën 1.1

Tabela 1.1.

Aktiviteti në kuadër të Shtojcës 1 të Ligjit Nr. 08/L-145 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes	**Përshkrimi i aktivitetit specifik**	**Kufijtë e aktivitetit specifik**
Prodhimi dhe përpunimi i metaleve	Shkritoret e metaleve me ngjyra me një kapacitet prodhues që tejkalon 20 ton në ditë.	Prodhimi i Fero-Nikelit me një kapacitet prodhues 40 t Ni /ditë

1.2 Aktivitetet e autorizuara sipas tabeles 1.1. nuk duhet të shtrihen përtej vendit, që paraqet zonën e përkufizuar sipas planit të mëposhtëm



Pamje e përgjithshme e fabrikës së Ferronikelit, siç është paraqitur në aplikacion

1.3. Impianti nuk duhet të futet në funksion përderisa nuk përmbushen procedurat e mëposhtme dhe përderisa nuk njoftohet me shkrim Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës.

2. ÇËSHTJET OPERACIONALE

2.1. Kontrolli dhe Teknikat e Menaxhimit

2.1.1. Impianti, duke iu nënshtruar kushteve të Lejes Mjedisore të Integruar, duhet të menaxhohet dhe kontrollohet siç përshkruhet në dokumentacionin e specifikuar në Tabelën 2.1.1, apo siç është rënë dakord me shkrim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukurës.

2.1.2. Të gjithë impiantet, pajisjet dhe mjetet teknike që përdoren për operimin e Impiantit duhet të mbahen në gjendje të mirë funksionale.

2.1.3. Impianti duhet të mbikëqyret nga një person i aftësuar, dhe që është plotësisht i familjarizuar me kushtet e Lejes Mjedisore të Integruar.

2.1.4 Një kopje e Leje Mjedisore të Integruar , duhet që të jenë në dispozicion në çdo kohë për punëtorët që janë të angazhuar në këtë drejtim, në pajtim me kushtet e Lejes Mjedisore të Integruar.

2.1.5 Të gjithë punëtorët duhet të njoftohen plotësisht me kushtet e Lejes, të cilat ndërlidhen me detyrat e tyre. Punëtorët duhet të aftësohen/trajnohen dhe duhet t'iu sigurohen, në formë të shkruar udhëzimet për operim, në mënyrë që të jenë të aftë t'i kryejnë detyrat e tyre.

2.2. Lëndët e Para dhe lëndët ndihmëse (Aditivët)

2.2.1. Operatori duhet t'i shfrytëzojë lëndët e para dhe lëndët ndihmëse të përshkruara në Tabelën 2.

Tabela 2.2.1

Të dhënat për artikullin përkatës	Kushti specifik	Dokumentacioni përkatës
Xehja,linjiti+petkoksi+gëlqerja, mazuti, qymyrguri i Indonezisë, dolomiti, oksigjeni(lëng+gaz)+biomasa	Rezervuarët e mazutit të kontrollohen, mirëmbahen dhe të sigurohen me murin mbrojtës prej betoni për të penguar rrjedhjen e pa kontrolluar të mazutit.	Plani i mirëmbajtjes
	Detyrohet Operatori ti merr të gjitha masat për shfrytëzimin efikas të lëndëve të para dhe lëndët	Regjistrimi

	ndihmëse në të gjitha pjesët e procesit,duke marr në konsideratë zvogëlimin e gjenerimit të mbeturinave dhe praktikat më të mira për këtë lloj të aktivitetit.	
	Ngarkimi dhe shkarkimi, si dhe deponimi i materialit të bëhet në vende të caktuara duke marrë masat e nevojshme që mos të vjen deri tek rrjedhja e tyre.	Plani i intervenimit në rast të aksidenti mjedisor
Materiali zjarrdurues	Operatori duhet të kontrollojë sasinë e materialeve zjarrduruese që përdoren në furrën rrotulluese furrën elektrike si dhe në konventor konsumimi vjetor duhet të jet i regjistruar.	Regjistrimi

2.2.2. Substancat e rrezikshme duhet të etiketohen sipas Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr.03/2021 për Menaxhimin e Mbeturinave të Rrezikshme.Etiketat me të dhëna mbi sigurinë e produktit duhet të jenë të pranishme dhe të jenë të azhurnuara; ruajtja e substancave të rrezikshme duhet të bëhet në kontejner dhe hapësira të përshtatshme, duke e marrë parasysh pajtueshmërinë kimike.

2.3. Shfrytëzimi dhe Efiçienca e Energjisë

2.3.1. Operatori duhet, në pajtim me kushtet e kësaj Leje, të shfrytëzojë energjinë siç përshkruhet në Tabelën 2.3.1

Tabela 2.3.1.

Burimi i energjisë apo konsumi specifik i saj	Kushti specifik	Dokumentacioni përkatës
Linjitin e Kosovës në furrën rrotulluese	Të merren masat parandaluese që të mos vjen te vetëndezja e lignitit.	Dokumenti teknik
Qymyrguri i Indonezisë në furrën rrotulluese Koksi në furrën elektrike Petkoksi në furrën rrotulluese	Të ruhen në vende ku nuk shpërndahet pluhuri	Dokumenti teknik

Linjiti i Maqedonisë në furrën rrotulluese.		
Mazuti në furrën rrotulluese, ngrohtore.	Rezervuarët e mazutit të kontrollohen, mirëmbahen dhe të sigurohen me murin mbrojtës prej betoni për të penguar rrjedhjen e pa kontrolluar të mazutit.	
Masë elektroda (lëndë djegëse e ngurtë) në furrën elektrike		
Energjia elektrike në dy furrat elektrike rreth 86% ndërsa 14% harxhohet në lokacionet tjera. .	Me qellim të përputhjes me TMD, operatori, në kuptimin e zvogëlimit të shfrytëzimit të energjisë elektrike, duhet të bëjë zëvendësimin e energjisë elektrike me një formë tjetër të energjisë kudo që të jetë e mundur.Operatori duhet ta përdor në mënyre efikase energjinë në të gjitha proceset e prodhimit aty ku është e mundur.	

2.3.2. Kërkohet nga operatori që të bëj një studim të fizibilitetit për shfrytëzimin e burive alternative të energjisë.

2.3.3. Operatori duhet të përdori vetëm ato lëndë djegëse alternative sipas lejes se veqant dhe licencave të lëshuara nga Ministria, pas ratifikimit të studimit të fizibilitetit.

2.4. Gatishmëria Emergjente

2.4.1 Në pajtim me kushtet e kësaj Leje, Operatori duhet t'i parandalojë dhe kufizojë pasojat nga aksidentet, siç përshkruhet në dokumentacionin e specifikuar në Tabelën 2.4.1

Tabela 2.4.1.

Ndodhitë apo mjetet potencialisht të dëmshme	Kushti specifik	Dokumentacioni përkatës

Rrjedhja e mazutit në stacionin e pompave/rezervuarët kryesor	Ndërtimi i basenit prej betonit-muri mbrojtës dhe mirëmbajtja e rregullt	Dokument teknik
Mbi rrjedhja e mazutit nga rezervuari ditorë me rrjedhje në tokë dhe pastaj përmes drenazhit arrin ujin në efluent	Ndërtimi i basenit nga betoni,ndarës i vajit para pikës së emisionit të ujit efluent	Dokument teknik
Shkarkimi i kemikateve (aditivët për trajtimin e ujit, acidet, bazat)	Praktikë e mirë e ruajtjes, zëvendësimi me aditiv të cilët nuk janë të rrezikshëm për Mjedisin	
Shkarkimi aksidental i ujit ftohës nga kullat ftohëse e cila mund të vjen nga mos funksionimi i pompës për ujë	Rritja e kapacitetit mbajtës në kullat ftohëse, mirëmbajtja e rregullt e pompës.	Raport i mirëmbajtjes
Rrjedhja e vajrave të përdorura	Vajrat e përdorura të ruhen në fuçi metalike, të jen të siguruara mirë.	Dokument teknik
Eksplodimi në precipitatorët elektrostatik (furra rrotulluese) kjo mund të vjen nëse përqindja e CO është e lartë në filtër , ekziston rreziku nga eksplodimi (elektrodat emituese)	Kontrollimi i përqindjes së CO, para se të hyj në filtër (PES).	Dokument teknik
Për shkak të temperaturës së lartë, të përfshirë në proces.	Fillimi apo ndalja e punës të bëhet në mënyrë graduale	Raport teknik

2.5. Dekomisionimi dhe Rehabilitimi

2.5.1. Me kushtet e përcaktuara në këtë Leje, Operatori, pas ndërprerjes përfundimtare të funksionimit të impiantit, duhet të i planifikoi masat për dekomisionimin e Impiantit dhe për rehabilitimin e vendndodhjes së tij.

3. ÇËSHTJET MJEDISORE.

3.1 . ATMOSFERA

3.1.1 Shkarkimet në ajër (emisionet)

3.1.2. Burimet e shkarkimeve në ajër janë të paraqitura në Tabelën 3.1.2.

Tabela 3.1.2

Pikat e shkarkimeve (emisioneve) në ajër	Fazat e prodhimit	Sistemi i pastrimit	Karakteristikat e pikës së emisionit
A2.1	Furrat rrotulluese	ESP	F= 220000 N m^3/h; T= 170°; h=100m
A2.3	Furra elektrike 1	Skruberi me ujë	F= 6.027,84 Nm^3/h T= 33.70°C, h=55m
A2.4	Furra elektrike 2	Skruberi me ujë	F= 5.559,84 Nm^3/h T= 33.40°C h=55m
A2.2	Konvertori	Skruberi me ujë	F= 119.559,20 Nm^3/h T= 41.10°C h=50m
A1.1	Ngrohtorja	Nuk ka trajtim	F= 19000 Nm^3/h; T= 240°C; h=12m

F- Rrjedhja vëllimore e gazit (m^3/h)
T- Temperatura e gazrave te emituara (°C)
h- Lartësia e oxhakut (m)

3.1.3. Nuk duhet të tejkalohen limitet për emisionet në ajër, për substancat dhe pikat e emisionit në ajër të specifikuara në Tabelën 3.1.3

Tabela 3.1.3.

Pikat e shkarkimeve (emisioneve) në ajër	Substancat	Vlera Kufitare e Emisionit (VKE)	Njësia matëse	Shpeshtësia
A2.1	Pluhuri	30	mg/Nm^3	Kontinuale

	SO_2	400	mg/Nm^3	Kontinuale
	NOx	400	mg/Nm^3	Kontinuale
	Hg+Cd+Ti	0.05	mg/Nm^3	Vjetore
	Pb+Fe+Ni+Cr+Co	0.05	mg/Nm^3	Vjetore
	PCDD/DF	0.1	ngTEQ/Nm^3	1 here/2 vite
A2.2	Pluhuri	30	mg/Nm^3	Kontinuale
	SO_2	400	mg/Nm^3	Kontinuale
	NOx	400	mg/Nm^3	Kontinuale
	Hg+Cd+Ti	0.05	mg/Nm^3	Vjetore
	Pb+Fe+Ni+Cr+Co	0.05	mg/Nm^3	Vjetore
	PCDD/DF	0.1	ngTEQ/Nm^3	1 here/2 vite
A2.3	Pluhuri	30	mg/Nm^3	Kontinuale
A2.4	Pluhuri	30	mg/Nm^3	Kontinuale
A1.1	Pluhuri	30	mg/Nm^3	Periodike
	SO_2	400	mg/Nm^3	Periodike
	NOx	400	mg/Nm^3	Periodike

3.1.4. Operatori duhet ti arrijë Vlerat kufitare të emisioneve në ajër për të gjitha substancat e specifikuara në Tabelën 3.1.4

Tabela 3.1.4

Pikat e shkarkimeve (emisioneve) në ajër	**Substancat**	**Vlera Kufitare e Emisionit (VKE)**	**Njësia matëse**	**Shpeshtësia**
A2.1	Pluhuri	20	mg/Nm^3	Kontinuale

	SO_2	400	mg/Nm^3	Kontinuale
	NOx	400	mg/Nm^3	Kontinuale
	Hg+Cd+Ti	0.05	mg/Nm^3	Vjetore
	Pb+Fe+Ni+Cr+Co	0.3	mg/Nm^3	Vjetore
	PCDD/DF	0.1	ngTEQ/Nm^3	1 here/2 vite
A2.2	Pluhuri	20	mg/Nm^3	Kontinuale
	SO_2	400	mg/Nm^3	Periodike
	NOx	350	mg/Nm^3	Periodike
	Hg+Cd+Ti	0.2	mg/Nm^3	Vjetore
	Pb+Fe+Ni+Cr+Co	0.3	mg/Nm^3	Vjetore
	PCDD/DF	0.1	ngTEQ/Nm^3	1 here/2 vite
A2.3	Pluhuri	30	mg/Nm^3	Kontinuale
A2.4	Pluhuri	30	mg/Nm^3	Kontinuale
A1.1	Pluhuri	30	mg/Nm^3	Periodike
	SO_2	400	mg/Nm^3	Periodike
	NOx	350	mg/Nm^3	Periodike

3.1.5. Operatori duhet ti arrijë Vlerat kufitare të emisioneve në ajër për të gjitha substancat e specifikuara në Tabelën 3.1.5.

Tabela 3.1.5.

Pikat e shkarkimeve (emisioneve) në ajër	**Substancat**	**Vlera Kufitare e Emisionit (VKE)**	**Njësia matëse**	**Shpeshtësia**
A2.1	Pluhuri	20	mg/Nm^3	Kontinuale
	SO_2	500	mg/Nm^3	Kontinuale
	NOx	300	mg/Nm^3	Kontinuale
	Hg+Cd+Ti	0.1	mg/Nm^3	Vjetore
	Pb+Fe+Ni+Cr+Co	0.2	mg/Nm^3	Vjetore
	PCDD/DF	0.5	ngTEQ/N	1 here/2 vite

			m^3	
A2.2	Pluhuri	20	mg/Nm^3	Kontinuale
	SO_2	400	mg/Nm^3	Kontinuale
	NOx	300	mg/Nm^3	Kontinuale
	Hg+Cd+Ti	0.1	mg/Nm^3	Vjetore
	Pb+Fe+Ni+Cr+Co	0.2	mg/Nm^3	Vjetore
	PCDD/DF	0.5	ngTEQ/N m^3	1 here/2 vite
A2.3	Pluhuri	20	mg/Nm^3	Kontinuale
A2.4	Pluhuri	20	mg/Nm^3	Kontinuale
A1.1	Pluhuri	20	mg/Nm^3	Periodike
	SO_2	400	mg/Nm^3	Periodike
	NOx	350	mg/Nm^3	Periodike

Nivelet e lejuara të materieve ndotëse në ajër, janë përcaktuar duke u bazuar ne nivelet të emisioneve ne ajër sipas Udhëzimit Administrativ Nr.07/2021, mbi Rregullat dhe Normat e Shkarkimeve në Ajër nga Burimet e Pa Lëvizshme të Ndotjes, si dhe BREF dokumentit duke përdor TMD.

3.1.6. Operatori duhet të bëj monitorimin e substancave të paraqitura në tabelat e Shtojcës 1.

3.1.7. Në pajtim me kushtet e kësaj Leje, Impianti duhet të operoj në mënyrën e përshkruar në dokumentacionin e specifikuar në Tabelën 3.1.7. si dhe duke i përdorur teknikat që përshkruhen në po këtë dokumentacion:

Tabela 3.1.7.

Të dhënat për artikullin përkatës	Kushti specifik	Dokumenti përkatës
Emisionet e CO_2	Operatori duhet ti përdor TMD, sipas BREF dokumentit, për ti minimizuar emisionet e CO_2 në ajër	Raport teknik
Emisionet e CO	Operatori duhet ti përdor TMD, sipas BREF dokumentit, për ti minimizuar emisionet në ajër nga CO	Raport teknik
Furra elektrike Oxhaku emergjent	Operatori duhet të minimizoj numrin e hapjeve të oxhakut emergjent, të furrës elektrike.	Grafiku i temperaturës në oxhakun emergjent;

	Operatori duhet të mbaj një regjistër për numrin e hapjes së oxhakut emergjent.	Libri i punës
Ngrohtorja	Operatori duhet të përdor ngrohtoren vetëm nëse puna e flakëhedhësit bëhet sipas udhëzimeve të prodhuesit.	Raport teknik
Furra rrotulluese-Sistemi kontinual i monitorimit të emisioneve	Operatori duhet të mbajnë një regjistër për kalibrimin e zakonshëm, mirëmbajtjen dhe mosfunksionimin e sistemi. Kalibrimi duhet të bëhet duke u bazuar në ISO14181 2005 Operatori duhet të ndërmerr masat, nëse sistemi nuk është duke punuar për një periudhë më të gjatë se 3 ditë	Regjistër të sistemit kontinual të monitorimit të emisioneve
Emisionet difuzive	Operatori duhet të bëjë transportimin e xehes me sistem të mbyllur, si dhe të vendos barrierave mbrojtëse nga era, spërkatje e përhershme e sipërfaqes operacionale përreth fabrikës dhe rehabilitimin e deponisë së skories pas mbylljes së sajë. Operatori duhet të zbatojë të gjitha masat e nevojshme për të shmangur shpërndarjen e emisionit të pluhurit në atmosferë, sidomos nga magazinimi i lëndëve të para.	Raport teknik
Cilësia e ajrit	Operatori duhet të bëjë monitorimin e cilësisë së ajrit përreth fabrikës dhe jashtë fabrikës për grimcat e suspenduara(PM_{10}, $PM_{2.5}$), CO, NO_X, SO_2, metalet e rënda Fe,Ni,Hg,Cr,Co,),të përcjell pozitën dhe frekuencën e përshkruar në Planin e Vetëmonitorimit.	Vendosja e pajisjes për matje automatike të cilësisë së ajrit ambiental ose marrjen e mostrave dhe analiza e tyre.
Mirëmbajtja	Furrat rrotulluese, elektrike dhe konvertorët duhet të jenë subjekt për mirëmbajtje të plotë së paku vjetore; Operatori është i detyruar për të bërë një planë për ndërhyrjen në mirëmbajtje dhe për të regjistruar aktivitetin e bërë.	Dokument teknik

Emisionet nga Dioksinat	Obligohet operatori që ti përdor TMD sipas BREF dokumentit për ti minimizuar emisionet në ajër nga dioksinat. Pas flakëhedhësit temperatura duhet të mbahet mbi 850°C Përdorimi i flakëhedhësit dhe pajisja me filtrim të thatë për ti zvogëluar emisionet.	

Nivelet e lejuara të materieve ndotëse në ajër, janë përcaktuar duke u bazuar ne nivelet të emisioneve ne ajër sipas Udhëzimit Administrativ Nr.07/202021, mbi Rregullat dhe Normat e Shkarkimeve në Ajër nga Burimet e Pa Lëvizshme të Ndotjes, si dhe BREF dokumentit duke përdor TMD.

3.1.8. Të gjitha emisionet nga Impianti duhet të mos kenë erë të pakëndshme jashtë kufijve të Impiantit.

3.1.9. Të gjitha emisionet në ajër, me përjashtim të avullit apo avullit të kondensuar të ujit, duhet të jenë pa pikëza, pa mjegull dhe tym te përhershëm.

3.1.10. Të gjitha emisionet nuk duhet të përmbajnë tym të dukshëm. Nëse për qëllim mirëmbajtjeje, emisionet e tymit shkaktohen si rezultat i arritjes së pikës së ndezjes nga të ftohtit, kjo nuk duhet të zgjasë më shumë se 20 minuta brenda periudhës kohore prej 8 orësh, si dhe duhet të ndërmerren të gjithë hapat praktik për ta reduktuar emisionin.

3.2. UJËRAT

3.2.1. Konsumi i ujërave

Operatori nuk duhet të tejkalojë limitet e konsumit të ujit të freskët, të specifikuar në tabelën 3.2.1

Tabela 3.2.1

Të dhënat mbi pikën e konsumit (abstraksionit)	Burimi i ujit	Limiti ditor i konsumit m3/ditë	Limiti vjetor i konsumit m3/vit
Uji për proces të prodhimit	Liqeni i Ujmanit		2400000 (m^3/vit)
Uji për pije, kuzhinë e sanitari	"KUR" Prishtina		420000 (m^3/vit

Operatori obligohet t'i përmbahet kushteve të caktuara në Lejen Ujore për Shfrytëzim, të lëshuar nga MMPHI

Sasia e ujit që del nga nyja e xehes dhe të konsumuar duhet të monitorohet dhe të raportohet sipas Shtojcës 1 (Plani i Vetë-Monitorimit)

3.2.2. Shkarkimet në ujëra

Shkarkimet në ujërat sipërfaqësore nga pikat e shkarkimit të specifikuara në Tabelën 3.2.2.1 duhet të burojnë vetëm nga burimi (burimet) e specifikuara

Tabela 3.2.2.1

Të dhënat për shkarkimet	Burimi	Sistemi i trajtimit	Lokacioni i pikës së emisionit
Uji industrial është ujë riqarkullues (nuk shkarkohet)	Uji i freskët për nevoja industriale	Uji riqarkullues	Ftohja e trupit të furrës elektrike, granulimi i skories, prodhimi i avullit(ngrohtorja), uji për depluhurimin e konvertorit dhe të FE
Gypi shkarkues i fabrikës (SW2 - në hartë)	Uji i trajtuar sanitar	Impianti për trajtimin e ujërave të zeza	Uji që rrjedh nga kuzhina dhe objektet tjera sanitare
Gypi shkarkues i fabrikes (SW2 – në hartë)	Uji që rrjedh nga fabrika	Në planin e përputhshmërisë (bazeni sedimentues)	Hapësira e fabrikës
Gypi shkarkues i fabrikës (SW2 – në hartë)	Uji nëntokësor	Me pompa dërgohet ne gypat e ujit atmosferik(nuk trajtohet)	Nyja e xehes (nën thërrmues-objekti 01)

Nuk duhet të tejkalohen limitet për shkarkimet në ujërat sipërfaqësore për parametrin (parametrat) dhe pikën (pikat) e shkarkimit të specifikuara në Tabelë 3.2.2.2.

Nuk duhet të ketë shkarkime të substancave në ujërat sipërfaqësore nga Impianti i Lejuar për të cilat në Tabelën 3.2.2.2 nuk është specifikuar limiti, përveç në rast se përqendrimi i tyre nuk është më i madh se përqendrimi i tyre i mëparshëm në ujërat sipërfaqësore përpara shkarkimit nga Impianti.

Tabela 3.2.2.2.Vlerat kufizuese të shkarkimit të substancave ndotëse në ujërat e ndotura nga objektet dhe stablimentet për prodhimin e ferronikelit

Pikat e burimit të emisionit	Parametrat	Shpre hur në:	Njësia	Ujërat sipërfaq ësore	Sistemi i kanalizi mit publik	Shpe shtës i e matje

						s
1. Uji për proces të prodhimit; 2. Uji për pastrimin e pajisjeve;	PARAMETRAT FIZIKO-KIMIK					
	1. Temperatura		°C Δt °C	[1]	40	4 / vit
	2. pH			6.5 – 9.0	6.5 – 9.5	
	3. Substancat e suspenduara		mg/l	20	(a)	
	4. Substancat e dekantueshme		mg/l	0.5	10	
	PARAMETRAT ORGANIK					
2. Uji për pastrimin e hapësirave punuese; 3. Uji për qëllime mjedisore; 4. Uji për qëllime sanitare e	5. Karboni total organik (TOC)	C	mg/l	30	-	4 / vit
	6. $SHBO_5$	O_2	mg/l	20	250	
	7. SHKO	O_2	mg/l	125	600	
	8. Substancat lipofile të (vajrat dhe yndyrat totale)		mg/l	20	100	
	9. Fenolet		mg/l	0.1	10	
	10. Hidrokarburet aromatike të paqëndrueshme (BTEX)		mg/l	0.1	1.0	
	11. Halogjenet organike adsorbile (AOX)		mg/l	0.5	0.5	
	12. Hidrokarburet totale		mg/l	10	30	
	13. Hidrokarburet e paqendrueshme të klorizuara		mg/l	0.1	1.0	
	14. Detergenti anionik		mg/l	1	10	
	15. Detergenti jojonike		mg/l	1	10	
	PARAMETRAT INORGANIK					
	16. Sulfatet	SO_4	mg/l	400	1000	4 / vit
	17. Sulfidet e tretura	S	mg/l	0.1	1	
	18. Fluoridet e tretura	F	mg/l	10	20	
	19. Kloridet	Cl	mg/l	250	1000	
	20. Azoti total	N	mg/l	15	50	
	21. Fosfori total	P	mg/l	1.5	10	
	22. Bakri	Cu	mg/l	0.5	0.5	
	23. Zinku	Zn	mg/l	2	2	
	21. Kadmiumi	Cd	mg/l	0.2	0.2	
	22. Kallaji	Sn	mg/l	2	2	
	23. Kromi total	Cr	mg/l	0.5	0.5	
	24. Vanadiumi	Vn	mg/l	0.05	0.05	
	25. Nikli	Ni	mg/l	0.5	0.5	
	26. Plumbi	Pb	mg/l	0.5	0.5	
	27. Hekuri	Fe	mg/l	2	10	

	28. Zhiva	Hg	mg/l	0.01	0.01	
	29. Cianidet e lira	CN	mg/l	0.1	0.1	
	30. Cianidet totale	CN	mg/l	0.5	1	

Operatori duhet ta menaxhoj procesin e punës në atë mënyrë, që do të bëjë të mundur që cilësia e ujit të shkarkuar, ti plotëson kërkesat për shkarkimin e ujërave të ndotura, sipas kategorisë duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2022 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese te shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujor.
Operatori duhet t'i përmbahet kushteve të Lejes Ujore për shkarkim, të lëshuar nga MMPHI.

Detyrohet operatori që të siguroj që testi i cilësisë së ujit dhe ndikimi i tyre në mjedis të merret përmes personave juridik që janë të autorizuar për kryerjen e testeve të tilla.
Operatori lajmëron organin përgjegjës për Mjedis,së paku një herë në vit për matjet e kryera. Nëse vjen deri te shkarkimi i pa kontrolluar i materieve ndotëse në ujë operatori është i detyruar që menjëherë të informojë organin përgjegjës për Mjedis.
Kur specifikohet në Tabelë limiti vjetor i masës për një substancë, shkarkimi total i asaj substance nga Impianti i Lejuar në ujërat sipërfaqësore nga pikat e shkarkimit të specifikuara në 3.2.2.2 dhe nuk duhet ta tejkalojë atë limit në asnjë vit.

Tabela 3.2.2.3

Pikat e emisionit	Receptori (sistemi i ujërave të zeza, trupi ujor	Sasia e ujit që shkarkohet m^3/h
Gypi shkarkues i fabrikës (SW2 – në hartë))-(uji i trajtuar sanitar + uji që rrjedh nga fabrika+ uji nëntokësor)	Trupi ujor (Lumi Drenica)	80 m^3/h

Operatori duhet t'i përmbahet kushteve të Lejes Ujore për shkarkim, të lëshuar nga MMPHI

3.2.3. Mbrojta e Ujërave Nëntokësore

Impianti i Lejuar duhet, në pajtim me kushtet e kësaj Leje, të kontrollohet siç përshkruhet në Tabelën 3.2.3. apo ashtu siç është rënë dakord me shkrim me Autoritetin Kompetent.

Tabela 3.2.3.

Të dhënat	Kushti specifik	Dokumenti përkatës

Gypi shkarkues i fabrikës (SW2 – në hartë)	Operatori duhet ta menaxhoj procesin e punës në atë mënyrë, që do të bëjë të mundur që cilësia e ujit të shkarkuar, ti plotëson kërkesat për shkarkimin e ujërave të ndotura, sipas kategorisë duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2022 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese te shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujor. Operatori duhet t'i përmbahet kushteve të Lejes Ujore për shkarkim, të lëshuar nga MMPHI	Regjistër
Impiantin për pastrimin e ujërave te zeza, gypat e ujërave atmosferike,ujërave të zeza	Detyrohet operatori që impiantin për trajtimin e ujërave të zeza, gypat e ujërave atmosferike,ujërave të zeza të mbaj në gjendje të rregullt Detyrohet operatori që të vendosë pajisjen matëse që matë dhe regjistron sasinë e ujërave të ndotura	Regjistër të pajisjes për trajtimin e ujit.

3.3.MBETURINAT

3.3.1. Prodhimi, magazinimi dhe menaxhimi

Operatori duhet, në pajtim me kushtet e kësaj Leje, të menaxhojë dhe magazinojë mbeturinat siç përshkruhet në Tabelën 3.3.1.

Tabela 3.3.1.

Përshkrimi i mbeturinës sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave	**Burimi**	**Lokacioni**	**Mënyra e ruajtjes**	**Kushtet e ruajtjes**
01 03 99 - Skoria e FE	Furra elektrike	Deponia e skories në Sukë	Deponohet	Deponohet në deponin e skories.
01 03 99- Skoria e konvertorëve	Konvertori	Deponohet afër seperacionit magnetik	Deponohet / Riciklohet	Riciklohet
10 02 14 - Lymi i skruberit	Trajtimi i	Objekti 19 –	Deponim i	Riciklohet

	gazrave dhe pluhurit në furra elektrike dhe konvertorë, ky lym shkon në fundërruesit radial	stacioni i lymit, ku prej aty transportohet në bunkerët furnizues të FRr	përkohshëm në stacionin e lymit - objekti 19	
10 02 06- . Material zjarrdurues	Konv+FRr+FE	Deponia për materiale të përkohshme brenda fabrikës	Deponohet	Deponim i përkohshëm
12 01 01 -Metali nga Tornim	Punëtoria qendrore	Deponia për materiale të përkohshme brenda fabrikës	Deponohet në kontejner 4 m^3	Deponim i përkohshëm
12 01 02-Gypat për fryrje	(EF + konvertor (FE+Konvertori)	Deponia për materiale të përkohshme brenda fabrikës	Riciklohet (shitet si skrap metali)	Riciklohet
15 01 04-Bure (fuqi) të dëmtuara(Fabrika +Miniera e Çikatoves)		Deponi për materiale të përkohshme brenda fabrikë	Deponim i përkohshëm	Deponim i përkohshëm
17 04 05-Llamarinë dhe metal tjetër (PQ+Energjetika		Deponi për materiale të përkohshme	Shitet si skrap metali	Deponim i përkohshëm
13 01 07*-Vaji hidraulik((Mirëmbajtja)		Deponia për materiale të rrezikshm (bazeni hapur prej betoni) është caktuar kryesisht për mbetjet e rrezikshme (vaj i përdorur, tank metalike, enë plastike, etj)	Ruhet në bure	Deponim i përkohshëm
13 02 03* -Vaji i përdorur (Mirëmbajtja+Transporti i brendshëm)		Deponia për materiale të rrezikshme (bazen i hapur prej betoni)	Ruhen në kontejner plastike 1000 L	Deponim i përkohshëm

		është caktuar kryesisht për mbetjet e rrezikshme (vaj i përdorur, tank metalike, enë plastike, etj		
15 01 02-Plastika (FE+Energjetika)		Hudhen nëpër kontejner të mbeturinave	Hudhen	Deponim i përkohshëm
20 01 04-Plastika (Laboratori)		Hudhen nëpër kontejner të mbeturinave	Hudhen	Deponim i përkohshëm
15 01 03- Dru nga paletat (Tr. brendshëm+Transporti i brendshëm)		Deponia per materje te përkohshme	Deponohen (Zakonisht i`u jepen punëtorëve falas)	Deponim i përkohshëm
15 01 07-Qelqe nga laboratori		Hudhen nëpër kontejner	Hudhen	Kompania private i merr këto mbeturina
16 01 03-Shirita transportues dhe goma(FRr+Obj.Xeh+Min +Tr)		Deponi per materje te përkohshme	Deponohen	Deponim i hapur
16 06 05*-Akumulatorë (Miniera+Transporti)		Deponi për materiale të rrezikshme (një vend e mbyllur)	Ruhen	Deponim i mbyllur
